



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 86

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10

Prishtinë, më 18 dhjetor 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Salihe Mustafa, Nazane Breca, Liburn Aliu, Flora Brovina, Gëzim Kelmendi dhe Bahri Thaçi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - koordinatore e Komisionit, Xheneta Sopjani - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 4.12.2013;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti;
4. Shqyrtimi i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre;
5. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 4.12.2013

Komisioni miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 4.12.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Fikrim Damka- Sa i përket këtij Projektligji, kemi pak vonesa nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa, si dhe nga Komisioni për Legjislacion, i cili ka pasur disa vërejtje. Komisioni për Buxhet ka dërguar një shkresë dhe ka kërkuar nga ne që t'i shqyrtojmë edhe një herë amendamentet. Në qoftëse pajtoheni, presim edhe pak, derisa Komisioni për Buxhet dhe Financa të pajtohet me amendamentet tona, nëse jo, e procedojmë për në seancë.

Salihe Mustafa- Edhe pse jemi vonuar, mendoj që duhet t'i japim kohë Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Time Kadrijaj- Tha se është më mirë ta presim Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe pas pushimit të fundvitit, ta shqyrtojmë edhe një herë dhe ta procedojmë për në seancë.

Liburn Aliu- Tha se është tepër vonë, sepse Komisioni për Buxhet dhe Financa ka pasur mjaft kohë ta trajtojë projektligjin. Unë mendoj që duhet ta procedojmë, le të dalin ata me vërejtjet e tyre në seancë.

Nazane Breca- Jemi vonuar shumë me këtë projektligji dhe po ngarkohemi pa nevojë. Unë propozoj që ta presim Komisionin për Buxhet deri në mbledhjen e ardhshme, nëse deri atëherë nuk paraqesin vërejtjet e tyre, atëherë ne e procedojmë për në seancë.

Bahri Thaçi- Tha se është e rëndësishme që ne t'i harmonizojmë qëndrimet tona dhe nga ky projektligj të fitojnë të gjithë ata që e meritojnë.

Sasha Gjokiq- Ne jemi që ligji të procedohet në seancë, sepse mjaft jemi vonuar dhe nuk kemi çka të shtojmë më tepër.

Fikrim Damka- Propozoj që në mbledhjen e parë të janarit, të futet në rend dite ky projektligj dhe të procedohet për në Kuvend.

Pas diskutimeve, shumica e anëtarëve të Komisionit u pajtuan me propozimin që Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, në mbledhjen e radhës, të procedohet në seancë, ndërsa vetëm deputeti Liburn Aliu ishte që Projektligji, në këtë mbledhje, të procedohet në seancë.

5. Shqyrtimi i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personave të dhunuar gjatë luftës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre

Fikrim Damka- Kemi marrë vërejtje nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, për shkak të mungesës së shifrave, si dhe kemi një shkresë nga z.Zhbogar, të cilën duhet ta diskutojmë. Gjithashtu, kryesuesi i grupit të punës, z. Aliu dhe deputetja Brovina, kanë marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit për Komunitete dhe do të na njoftojnë për takimin.

Flora Brovina- Sa i përket letrës së Zhbogarit, e cila për mua është krejtësisht e pakuptimtë, mendoj që z. Zhbogar nuk e ka lexuar ligjin fare. Sa i përket përdorimit të terminologjisë, në vend të fjalëve: “ **person i dhunuar gjatë luftës**”, të përdoret: “ **viktima të dhunës seksuale të lidhur me luftën**”. Ne si komision, duhet të takohemi me Zhbogarin dhe të diskutojmë për këtë çështje.

Liburn Aliu- Sa i përket letrës së Zhbogarit, pajtohem me znj.Brovina. Ndërsa, sa i përket takimit me Zhbogarin, mendoj që duhet patjetër ta realizojmë, por nuk guxojmë të ndikohemi, dhe çështja tjetër, është se në takimin që kemi pasur me Komisionin për Komunitete, kemi diskutuar për çështje të terminologjisë kontestuese, ka mbetur një çështje, e cila është e natyrës gjuhësore, nuk ka nevojë të amendamentohet. Është fjala për Nenin 3, Amendamenti 1, fundi i fjalisë thotë: “*ekskluzivisht kundër forcave ushtarake, policore dhe administratës okupuese serbe në Kosovë*”. Fjala “serbe” për Komisionin për Komunitete, po nënkupton sikur ka të bëjë me etninë dhe jo me shtetin.

Ata insistojnë që në vend të fjalës “serbe” të shkruhet “ të Serbisë”.

Sasha Gjokiq- Edhe pse nuk e kam marrë mendimin e grupit tim parlamentar, jam që ligji të procedohet dhe të mos bëhet dallim se cilit komunitet i takojnë viktimat. Socialdemokratët tanë janë që për të gjithë që ekzistojnë fakte që kanë marrë pjesë në krime, të dënohen.

Liburn Aliu- Propozoj që Projektligji të procedohet menjëherë në Kuvend.

Bahri Thaçi- Kam një propozim konkret që gjatë amendamentimit, kemi harruar ta përfshijmë, te amendamenti 1, pika 1.7.2, në fund të fjalisë: “përkatësisht, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së” të shtohet: “apo në ish- Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës”. Unë mendoj që këtu nuk dëmtohet askush, si dhe te pika 1.7.4, në fund të fjalisë: “përkatësisht, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së”, të shtohet: “apo në ish- Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës”.

Sasha Gjokiq- Pajtohem që ta shtyjmë procedimin e këtij projektligji dhe ta caktojmë një takim me z. Zhbogar, si dhe të sqarojmë se cilat janë organizatat që kërkojnë ndryshime në këtë projektligj.

Nazane Breca- Nëse ne nuk i fusim edhe pjesëtarët e ish- Ministrisë së Mbrojtjes, atëherë bëjmë një padrejtësi të madhe kundrejt shumë njerëzve, të cilët kanë dhënë jetën për lirinë e vendit.

Liburn Aliu- Unë jam dakord që asnjë kategori që ka luftuar, të mos mbetet jashtë ligjit, por mendoj se të gjithë që kanë luftuar kanë qenë pjesë e UÇK-së, pa marrë parasysh ku e kanë filluar dhe zhvilluar aktivitetin e tyre.

Komisioni, pas diskutimeve, vendosi që propozimi i deputetit Bahri Thaçi, të diskutohet në mbledhjen ardhshme.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka